



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN DHE NJOFTIMIN ME PUBLIKUN

Nr. 7467 prot

Roskovec , më 04.09 .2025

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Në bazë të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit Nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18, të Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike,

Ju njoftojmë se do të zhvillohen dëgjesa publike ditën e Mërkurë, datë 24.09.2025, ora 11:00 në sallën e Këshillit Bashkiak, me grupet e interesit; bar, restorante , biznese që përdorin hapsirat publike në bashkinë Roskovec dhe në orën 13:00 me komunitetin dhe cdo palë e interesuar për:

"PËR RISHIKIM TË VENDIMIT NR.11 DATË 26.02.2021 "PËR MENAXHIMIN E HAPSIRËS PUBLIKE NË BASHKINË ROSKOVEC"

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të emailit:

Paola.goga@bashkiaroskovec.gov.al Koordinator për Njoftim dhe Konsultim Publik
Arlinda.hajdini@bashkiaroskovec.gov.al Sekretari i Këshillit

*Kjo dëgjesë do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak ku do të marrin pjesë përfaqësues të Këshillit Bashkiak.
Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin!*

KRYETAR
Majlinda Buçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1591 Prot.

Roskovec, më 01.03 2021

VENDIM

NR 11 .DATË 26.02 .2021

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE RREGULLAT E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE NË BASHKINË ROSKOVEC”

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k”, nenit 64, shkronja “c” të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 4/1 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar); nenit 10, nenit 11, nenit 15 dhe nenit 17 të vendimit nr. 1096, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Roskovec”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ,Drejtoria e Të Ardhurave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.
4. Bashkëngjitur këtij vendimi :Rregullorja “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Roskovec”.

KRYETAR
Kadri Hyska

